

Nazmi Rrahmani

Shkrimtar, gazetar dhe redaktor

Quhem Nazmi Rrahmani, kam lindur në fshatin Ballovc të komunës së Podujevës, me 7 maj 1941. Shkollën fillore katër klasëshe e kam kryer në fshat, atëherë është hapur për herë të parë shkolla fillore aty, do të thotë rreth vitit 1947. Kam filluar diku në gjysë vjetorin e dytë dhe mas tri vjetë e gjysë, do të thotë në atë shkollë kam vazhdu, në shkollën atëherë shtatë vjeçare në Podujevë. Kurse gjenerata ime për herë të parë, në shkollë u bë me tetë vjet, shkolla fillore do të thotë me tetë vjet, dhe mas shkollës fillore kam vazhduar gjimnazin në Prishtinë, kam kryer gjimnazin. Pas gjimnazit u hap dega e Gjuhës dhe Letërsisë, fakultetit të Gjuhës dhe Letërsisë në Prishtinë, do të thotë në vitin 1960, viti shkollor, 1959 - '60, dhe jam gjenerata e parë në këtë fakultet. Por meniherë pas gjimnazit kam filluar të punoj në Radio Prishtinë, gazetar, dhe aty kam vazhduar punën për diku nja afër 15 vjet, dhe prej aty kam kaluar në Rilindje. Në fillim në revistën "Fjala", mandej në revistën "Jeta e Re", dhe prej "Jetës së Re", në Redaksinë e Botimeve të Rilindjes, ku edhe kam përfunduar si të them karrierën e punës. Kam përfunduar me mbylljen e Rilindjes, dhe kemi vazhduar si redaksi punën edhe gjatë atyre vjetëve të randa të okupimit, mbasi u mbyll Rilindja, dhe e kam përfunduar në vitin 1999, për ta formuar shtëpinë botuese "Faik Konica" me t'cilën merrem edhe sot. Kjo është përafërsisht një pjesë e punës sime, po pjesa më e madhe ka qenë brenda Rilindjes, jo vetëm si aktivitet, them marrëdhënie pune, por edhe si aktivitet i përgjithshëm. Në vitin 1960 - '61 kam filluar të shkruaj, dhe në vitin 1965 e kam botuar romanin e parë "Malësorja", për të vazhdu mandej edhe me disa romane të tjera.

E unë për vete e marr si nisje ndoshta përkrahjen e nxitjen që ta jep mësuesi ose arsimtari i gjuhës e i letërsisë, ose në shkollë, në hartimin... në përkrahjen që ta jep me rastin e një hartimi ose të një shkrimi. Apo rast që, nuk mundet të jetë ndoshta vendimtar, por megjithatë, unë e mbaj mend, për shembull arsimtarin e gjuhës, ka qenë Shefqet Kelmendi, i Pejës, po atëhere punonte në Podujevë, ku para klasës ma livdon hartimin, që e kishim bo të zakonshëm... edhe noshta ai ka qenë fillimi. Po mandej edhe në gjimnazin e Prishtinës, për shembull profesori i gjuhës, më jepte librat të lexoj, libra që s'mund t'i gjejshe, unë e kom lexuar Ernest Koliqin për shembull si nxanës i gjimnazit, që ma ka dhanë profesori vetë. E kështu që ato janë shtytje që ndoshta e fillojnë dhe mandej vazhdon. Kjo nuk do të thotë që vlenë për të gjithë, secili e ka ni pikënisje, ni diçka që e shtynë. Ndoshta ni lexim që i pëlqen, noshta ni fjalë e mirë e dikuj', si fëmi mund ta nxitë, edhe...



Në foto: Nazmi Rrahmani

Nga arkivi personal i Nazmi Rrahmanit

Në Rilindje ka qenë puna, për mua, puna më e përshtatshme, puna ma e mirë e mundshme. Prandaj edhe e kam bërë me qejf, e kam bërë me dëshirë shumë të madhe, sepse kam pasur mundësi të merrem me krijimtarinë letrare, të merrem me dorëshkrimet, dhe me një përpjekje për të botuar dhe për t'i dhënë lexuesit atë që ma ka marrë mendja që është ma e mira dhe ma e nevojshme për kulturën në përgjithësi. Prandaj edhe atë punë e kam bërë, e kam kryer me dëshirë shumë të madhe, dhe me ndoshta, edhe me një angazhim të madh, sepse për shkak të vëllimit të dorëshkrimeve, për shkak të vëllimit të madh të veprave të cilat duhej lexuar dhe duhej lejuar për shtyp ose për punë të mëtejshme. E ka qenë aq i madh, sa shpesh herë më është deshtë të punoj edhe në shpi, ose t'i kryej puntë edhe jashtë redaksisë. Për shkak se, në atë kohë si udhëheqës i asaj redakise, natyrisht kam pasë dhe obligime të tjera, dhe të kolektivit... edhe të kolektivit të përgjithshëm të Rilindjes, sepse Rilindja siç dihet ka qenë një kolektiv shumë i madh, ka qenë heterogjen, me veprimtari shumë të gjëra, edhe pse nganjëherë të ndryshme. Duke filluar prej shtypshkronjës, pra prej atyre elementeve të punës konkrete, të maqinave, të letrës, të shtypit, të qarkullimit e të tjera, deri te shitja e librit ose shpërndamja e librit, deposë, organizimit që duhej. Por, meqenëse udhëheqësit e sektorëve të ndryshme të Rilindjes, që atëherë i thojshin “Organizata të Punës së Bashkuar”, ka qenë edhe një udhëheqje kolektive e Rilindjes, prandaj edhe obligimet që kam pasur në atë drejtim kanë qenë që të merrem edhe me problemet dhe me çështjet e sektorëve të tjera. Për shkak të udhëheqjes, dhe

për shkak të problemeve që duhej zgjidhur në mënyrë të përbashkët për krejt kolektivin e Rilindjes, që ka qenë një kolektiv shumë i madh, dhe një kolektiv me kuadra, jo vetëm të shkolluara, të përgatitura me eksperiencë dhe me kushte jashtëzakonisht të larta, të mira. Prandaj ajo ishte një punë që duhej patjetër të kryhej dhe të angazhoheshin një numër shumë i madh i njerëzve që punonin aty. Për shembull, Rilindja si Redaksi e Botimeve, po flas vetëm për këtë pjesë, sepse një kohë organizimi i Rilindjes ka ndryshu, e nuk ka qenë ky që ka qenë në fund. Në fillim ka fillu të dalë gazeta me 12 shkurt 1945. Ka filluar të dalë gazeta, disa prej institucioneve të atëhershme, kanë botuar libra, në radhë të parë libra propagandistik, politik. Mandej Rilindja kur osht' formu si shpi botuese, është formu me emrin "Mustafa Bakija", jo si Rilindje. Me këtë emën, me këtë titull që ka pasë, si Mustafë Bakija, ka botuar disa prej veprave të fillimit. Fillimi ka qenë me botime, përkthime. Në radhë të parë, koha ishte '47, '48, '46 kur janë botuar kryesisht përkthime nga rusishtja, nga serbishtja, nga gjuhët e popujve të Jugosllavisë. Kurse më vonë ka filluar edhe të merret edhe ka zgjeruar veprimtarinë e vet edhe me botime tjera. Në vitin 1953, për shembull, janë botue dy libra të Martin Camajt , e di që janë librat e parë, me poezi të autorëve shqiptarë, po në atë kohë është botue libri i parë i Rexhep Hoxhës "Gjethe të Reja", është botuar... që është libri i parë i botuar i një autori nga Kosova. Ose Anton Çeta, Mark Krasniqi, Sejtki Imani, janë librat e parë, autorët e parë që ka botuar Rilindja, dhe mandej ka vazhduar ta zgjerojë veprimtarinë edhe me krijimtarinë origjinale, po edhe me përkthime të ndryshme.

Jam i bindur, meqenëse atëherë botoheshin tirazhe relativisht të mëdha, kur pak ka pasë njerëz me shkollë të kryera, përveç një numri të mësuesve, e ajo ka luejtë rolin, botimet e asaj kohe kanë luejtë rolin e vet në krijimin e autorëve të ri, jo veç në shkollimin e tyre, po edhe në aftësimin e tyre për t'u marrë me krijimtari, për të filluar edhe ata të shkruajnë. Prandaj vjen gjenerata tjetër e autorëve, si Latif Berisha, Besim Bokshi, Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, e tjerë, të cilët filluan t'i botojnë veprat e tyre të para; dhe për të vazhduar mandej edhe me një gjeneratë edhe më të frytshme të Azem Shkrelit, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, e tjera, për të vazhduar mandej gjithnjë tue u shtue numri i autorëve dhe veprave të botuara.

Prandaj kjo vetëvetiu tregon se krahas shkollimit, krahas kryerjes së shkollave edhe të mesme edhe të larta, shtohet edhe numri i autorëve, shtohet edhe numri i veprave, natyrisht shtohet edhe numri i veprave të përkthyer, po edhe i veprave të fushave të tjera. Tash kemi vepra gjuhësore, kemi vepra nga historia, nga mitologjia...

Edhe Rilindja ka qenë si gjithë kolektivët tjera, edhe pse ai procesi i punëve në Rilindje është pak i komplikuem, te botimet për shembull, është pak ma i komplikuem, sepse duhet të marrin pjesë shumë njerëz, jo vetëm një, për shembull, është autori që e bjen dorëshkrimin ose që e shkruan veprën. Kanë qenë recenzentët, ka qenë redaktori i pari që duhet ta lexojë edhe t'i japë vërejtjet ose të thotë, ose në qoftë se ka vërejtje, ose në qoftë se s'ka vërejtje të thotë që vepra është e mirë dhe mund të botohet. Mandej në atë kohë ka qenë sistemi i recenzentëve, që kanë qenë përfaqësues si të them shoqëror, të shoqërisë, jashtë Rilindjes, të cilët kanë marrë përgjegjësinë për botimin e ndonjë vepre. Ata është deshtë ta lexojnë dhe të japin mendim me shkrim që libri, vepra, romani, përmbledhja e poezive, e të tjera, është e mirë ose ka këtë të metë, këtë të metë, ose edhe që s'mund të botohet, në këtë nivel që është nuk mund të botohet. Prandaj kjo ka qenë ajo faza e parë e punës së çdo dorëshkrimi. Faza tjetër është ajo duhet të

shkojë në shtypshkronjë, në të vërtetë përpara duhej përgatitej teknikisht. Ka qenë redaktori teknik, i cili është marrë me përgatitjen e faqeve, me... ja ka shkruar çfarë germash duhet me përdorë, çfarë, ku duhet të jetë *italik*, ku s'duhet të jetë, sa është madhësia e rreshtit, sa... kështu që, ajo ana teknike e librit ka qenë tekniku, dhe ajo ka shku në shtypshkronjë, është bërë rradhitja. Puna në shtypshkronjë ka qenë tepër e mundimshme, ajo është bo me radhitjen në plumb, germë për germë, plumbi asht' shkri dhe ka formu germën, ka formu rreshtin. Të gjitha ato tekste osht' deshtë mandej t'i lexojë korrektori. Korrektori t'i gjejë gabimet. Korrektori është mbështet në dorëshkrim, në qoftë se në dorëshkrim ka qenë gabim, ai duhet gabim me shkru, prandaj kjo. Janë bo korrigjimet, prap duhet të lexohet deri sa të lejohet për shtyp, ka ndodhë m'u lexu edhe dy herë ose tri herë dorëshkrimi, prandaj gjithë ato janë punë të vështira, punë që zgjasin. Prandaj libri në atë kohë, nuk ka pasë kompjuter, prandaj, shkante me vështirësi shumë ma të mëdha. Dhe në fund mas gjithë kësaj ka pasë mundësi për shembull, që dikush prej së jashtmi, prej lexuesve, prej politkës, të thotë, "Pse është botu ky libër, ku shkruan kështu, kështu?", prandaj të gjitha këto janë pjesë e një pune bukur të mundimshme, një pune sigurisht në atë kohë, sidomos në atë kohë, ka qenë me përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe.



*Takim në zyrën e Rexhep Zogaj (drejtor i Rilindjes), 1980
Nga arkivi personal i Nazmi Rrahmanit*

Unë kam filluar të punoj në ndërtesën e vjetër të Rilindjes ma së pari. Ajo ndërtesë ka qenë një dy katëshe ku sot është parking. Ajo te muzeu ka qenë gazeta, kurse revistat kanë qenë në një

barakë këtu te stadiumi. Kështu që ka qenë në kushte jo të mira. Krejt redaksia e botimeve i ka pasë nja tri, katër zyre, ku ajo kryesorja ka qenë e kryeredaktorit, mandej nëpër zyre punojshim ka tre, katër vetë. Edhe kur ka filluar të ndërtohet pallati atëherë ka qenë e parapame çdo gjë. Është bërë një projekt i përgjithshëm për Rilindjen, por edhe për mjetet e tjera të shtypit në Kosovë. Për librin shkollor, për “*Jedinstvo*” në gjuhën serbo-kroate, për “*Tanin*” në turqisht, edhe “*Komunisti*” ka qenë në gazetë që e botonte partia. Kështu që për të gjitha është bërë pallati i parapamë që të jenë në një vend dhe në kushte jashtëzakonisht të mira, dhe ndërtimi i pallatit ka krijuar edhe mundësi për zgjanim. Natyrisht dikur numri i revistave ka qenë shumë më i vogël, por vinte duke u shtuar, pos “*Jetës së Re*”, që ka filluar që është, dhe “*Pionierit*” që janë revistat e para që kanë filluar në gjuhën shqipe. Asht’ bërë “*Përparimi*”, mas një kohe, “*Zëri i Rinisë*”, ka qenë atëherë, kanë filluar edhe gazetatat... ksi, revista të tjera si “*Fjala*”, “*Shkëndija*” për arsimin, “*Thumbi*” ka qenë revistë për humorin, “*Bati*” ka qenë bazat e arsimit teknik për nxanës, “*Pioneri*”, gazeta e pionerëve ka qenë në gazetë informative për nxanës. Edhe kështu që është zgjeruar edhe numri i revistave, edhe numri është shtuar shumë tirazhi i gazetës, për shembull që dilte zakonisht rreth 100 mijë brenda ditës, në raste festave shkonte edhe dy-treqind mijë gazeta. Tirazhi i librave po ashtu ka ardhë duke u shtuar sepse është shtuar numri i bibliotekave. Kanë qenë gjithsej 212 biblioteka në Kosovë. 212 biblioteka i kanë marrë secila të gjithë librat që kanë dalë. Do të thotë 212 copë kanë shkue si dokumentacion nëpër biblioteka për t’i pasë ajo në fondin e vet dhe në qoftë se është e interesuar atëherë blen tirazh të caktum, sepse bibliotekat duhen zakonisht me pasë më shumë ekzemplarë. Dhe Rilindja, qysh ka dalë çdo libër, e ka dërguar nëpër këto 212 biblioteka. Kanë qenë edhe bibliotekat e shkollave dhe bibliotekat e kolektive punuese që gjithashtu kanë marrë tirazhe. Tirazhi ma i vogël i librit ka qenë një mijë copë, ma i madhi ka shku deri në 20 mijë. Fjalori i gjuhës shqipe për shembull, vëllimi është botu 20 mijë, që ka qenë një sasi e letrës diku rreth 27 ton letër kanë ardhë prej Austrie, me ditë t’ana me kamione.

<<< *Ambient i punës në shtypshronjë* >>>

Shtypshkronja kur është bërë, kjo këtu¹ ka qenë ndër shtypshkronjat më moderne në vend, sepse ka qenë ma e reja, të gjitha maqinat janë ble të reja, ato që kanë qenë, kanë mbetë, janë largu ato të vjetrat, ka qenë më e reja, më modernja. Kështu që ka pasë mundësi të punëve shumë të suksesshme. Shtypshkronjën e kam njoftë në detale, i kam njoftë krejt njerëzit pothuaj aty. Kanë qenë punëtorë të mbrekullushëm. Aty kanë pasë, kanë pasë, edhe... ata kanë pasë kushte të mira por vlerësimi i punëtorëve të shtypshkronjës ka qenë si i minatorëve, sepse kanë punuar edhe me plumb, kanë punuar edhe në kushte ma të randa, kështu fizike. Prandaj kanë qenë edhe punëtorë të mirë.

¹ l’u referohet Pallatit të Shtypit të vitit 1972 This footnote needs to be incorporated as a footnote



Vizita e Ismail Kadaresë në Rilindje

Në foto: nga e majta në të djathtë, Nazmi Rrahmani, Ismail Kadare, Rexhep Zogaj, Azem Shkreli, Fadil Bujari dhe Ismail Berisha

Nga arkivi personal i Nazmi Rrahmanit

Po Rilindja në një kohë ka qenë gjithçka për njeriun tonë . Rilindja në kohën kur s'kem pasë institucione, s'kem pasë, akademi s'ka pasë. Instituti Albanologjik nuk ka funksionu, ka qenë i mbyllun. Instituti i Historisë po ashtu ka qenë i mbyllun. Këto institucionet tjera kulturore me aktivitete të ndryshme nuk ka pasë, ENT-i ka qenë repart i ENT-it të Serbisë, për botimin e teksteve shkollore. Prandaj Rilindja edhe si gazetë, edhe si revistë, po edhe si libër ka qenë ajo që në Kosovë e ka mbajtur gjallë gjuhën, zhvillimin kulturor edhe ka qenë praktikisht mundësi e një prosperiteti dhe një zhvillimi të pjesës së njerëzve të cilët kanë kryer shkollë. Sepse edhe numri i nxënësve nëpër shkolla të Kosovës ka qenë i vogël, dhe pjesa më e madhe e shkollave përveç normales dhe gjimnazit kanë qenë serbisht. Prandaj Rilindja si gazetë, mandej si revista, “Jeta e Re”, për shembull në atë kohë ka shku në 10 mijë copë tirazhi, sepse “Jeta e Re” shkonte si lektyrë shkollore nëpër shkolla. Prandaj Rilindja ka qenë, ndoshta, mund të them, e vetmja dritare që prej të cilës kanë mujtë njerëzit të shikojnë në gjuhën e kombit të vet, të shikojnë interesat e kombit të vet, edhe të zhvillimit kulturor dhe shkencor e të fushave të tjera. Nuk ka pasë tjetër pos Rilindjes, që ka mujtë me ndikue aq dukshëm. Prandaj edhe mas vitit 1981 në ato përpjekjet të... edhe të Serbisë, po edhe të Jugosllavisë, për t'i gjetë shkaktartë, e një dami, një indoktrinimi si i thojshin, ni dami politik që e qujshin, Rilindja ka qenë një prej atyne pikave krahas universitetit që ka bërë ndikimin më të madh. Prandaj edhe kërkohej që të bahej

një diferencim që një pjesë e veprave të karakterizohen si burim i ndikimit edhe të merren si faktore për gjendjen e krijuar.



Vizitë në Gjirokastrë, 1970

Në foto: nga lartë - poshtë, Rahman Dedaj, Ali Podrimja, Nazmi Rrahmani, Ali Aliu

Nga arkivi personal i Nazmi Rrahmanit

Gjithçka për Rilindjen... gjithçka për Rilindjen e kujtoj me nostalgji edhe e kujtoj me shumë emocione, për shkak se kurrë s'ma ka marrë mendja që Rilindja mund të shuhet. Kurrë nuk më ka shku menja që për shembull gazeta mund të mos të dalë, ose që Rilindja me tonë atë... ta ndërpresë punën. Por e ndërpreu... e ndërpreu në vitin '99, [mendohej] ksi në vitin 2000, prap e vazhdoi një kohë të shkurtë, u bënë ngatërresa mes njerëzve, "Financohet, s'financohet", u mbyll... Rilindja.

Unë më ni grup, nga pesë vetë, kemi bo ni shkresë Ministrisë të Drejtësisë e cila është në pallat, t'i vëhet vetëm një pllakë ku shkruhet se, "Këtu ka qenë Rilindja", edhe nuk osh' bo. Prandaj edhe sot, edhe sot mendoj që gabim shumë i madh i politikës sonë, i shtetit, i qeverisë, i ministrisë, asht' që Rilindja asht' mbyllë.